



Prishtinë: 19.05.2016
Kodi i ZRRE-së: V_817_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1438_01_15**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **27.01.2016**.

në seancën e mbajtur më datë **19.05.2016**, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Avdyl Blakqori me shifër DPR- 90072169 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1438_01_16** i datës 08.01.2016.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 05.01.2016 ka pranuar ankesën e konsumatorit N. M. me të cilën ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, i cili ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që të shqyrtoj ankesën e lidhur me borxhin e ngarkuar nga KESCO përmes faturës së rikthimit të humbjeve, si shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 05.01.2016 ka pranuar ankesën e konsumatorit N. M., si dhe vendimin numër C.nr.2061/15 të datës 13.11.2015 të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike në vlerë financiare prej 1,392.49 €.

Me datë 06.07.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS për inspektimin e pikave matëse kanë dalë në pikën matëse të konsumatorit ku kanë konstatuar se njehsori elektrik nuk posedon bllomb distributive dhe se janë kontrolluar hyrje daljet dhe gjatë kontrollës është konstatuar se bllomba shtetërore në anën e djathtë të njehsorit është e dëmtuar. Gjithashtu konsumatorit i janë regjistruar pajisjet për shfrytëzimin e energjisë elektrike, mbi bazën e të cilave është ngarkuar edhe konsumatori

Departamenti i Faturimit të KESCO mbështetur në Procedurën e përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike me datë 07.07.2015 e ka ngarkuar konsumatorin me faturë të rikthimit të humbjeve nr. DPR15HP16449 në vlerë financiare prej 1,392.62€.



Nga shkresat e lëndës vërtetohet se në bazë të ankesës së konsumatorit, Departamenti për Konsumator në KESCO me datë 28.07.2015 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në procesin nr. 0436978 i datës 06.07.2015, faturën e rikthimit të humbjeve DPR15HP16449 të datës 07.07.2015, si dhe Procedurën e përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Në përgjigjen e KESCO konsumatori është udhëzuar me këshillë juridike që pala e pakënaqur kundër këtij vendimi mund të inicioi kontest në gjykatën kompetente në afatin prej 14 ditëve.

Ndaj vendimit të KESCO-së, konsumatori N. M. sipas këshillës juridike i është drejtuar gjykatës me padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm nga Baza e kontestit: Për kthimin e borxhit të ngarkuar si shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike në vlerë financiare prej 1,392.62€.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm ne seancën e mbajtur me datë 13.11.2015 në çështjen juridike të paditësit N. M. kundër të paditurës KESCO, në Prishtinë për rikthim të borxhit, me Aktvendimin numër C.nr.2061/15 ka shpall veten inkompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së të paditësit N. M. kundër të paditurës KESCO, në çështjen juridike kthimi i borxhit të energjisë elektrike.

Gjykata në pikën II të dispozitivit të aktvendimit ka hedhë poshtë si të palejuar padinë e paditësit N. M. kundër të paditurës KESCO. Arsyet e hedhjes poshtë të padisë gjykata i ka arsyetuar duke u bazuar në Ligjin e Rregullatorit për Energji përkatësisht neni 16 par. 1 pika 3 ku parasheh që Zyra e Rregullatorit për Energji ka kompetencat për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë. Gjithashtu gjykata i është referuar edhe dispozitës së nenit 25 par 1 pika 2 të njëjtit ligj, ku ZRRE ka kompetencë të nxjerr vendime për zgjidhjen e kontesteve sipas nenit 16 të këtij ligji.

Gjykata gjithashtu Gjykata në aktvendim për jokompetencë është mbështetur edhe në nenin 18.2 si dhe nenit 387.1 pika (u) të Ligjit për Procedurën Kontestimore..

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2016 ka analizuar ankesën me të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga ana e konsumatorit N. M. dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se ankesa e konsumatorit ka të bëjë me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së, ka konstatuar se vendimi i DMK-së numër **ZRRE/DMK_V_1438_01_16** i datës 08.01.2016 është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla në fuqi. Neni 39 i Ligjit për energjinë elektrike përcakton në mënyrë specifike veprat penale që ndërlidhen me vjedhjen e energjisë elektrike. Bordi gjithashtu ka konstatuar se bazuar në nenin 4 paragrafi 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në sektorin e energjisë theksohet: “çdo ankesë ose kontest që lidhet me elementet e veprës penale dhe vjedhjes së energjisë elektrike, të përcaktuara në nenin 39 të Ligjit për Energji Elektrike, janë nën juridiksionin e gjykatës kompetente, andaj këto ankesa ose konteste nuk trajtohen në këtë rregull”.

Bordi gjithashtu ka konstatuar se edhe në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës kapitulli XXVI, përkatësisht nenet 319, 320, 321, 322, 323 dhe 324 i definojnë saktë veprat penale kundër shërbimeve komunale ku ndër to parashihet edhe vjedhja e energjisë elektrike, andaj mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 39 të Ligjit për energjinë elektrike, si dhe dispozitat e nenit 4 paragrafi 2 të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë është vendosur se Zyra e Rregullatorit për Energji nuk ka kompetencë që të merret me shqyrtimin e ankesave që kanë elemente të veprës penale, vjedhje e energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së, ka konstatuar se vendimi i Departamentit për konsumator në ZRRE, ka të bëjë vetëm me kompetencë lëndore që do të thotë se në këtë vendim nuk është shqyrtuar çështja meritore, gjithashtu në vendim nuk është konstatuar se konsumatori a është kryes i veprës penale, vjedhje e



energjisë elektrike apo jo, por vetëm se i është përgjigjur konsumatorit dhe gjykatës se ZRRE nuk ka mandat ligjor për shqyrtimin e kësaj ankese. Gjithashtu është konstatuar se konsumatori në asnjë rrethanë nuk i është referuar çështjes se a janë shkelur dispozitat ligjore nga organi i shkallës së parë DMK për mos shqyrtimin e ankesës, por vetëm se nga i njëjti ka vepruar sipas këshillës juridike ku fillimisht ka parashtruar ankesë në KEDS, pastaj në gjykatë, dhe se gjykata e ka shpallur veten inkompetente duke më udhëzuar për ankesë në ZRRE dhe se sipas vendimit të DMK në ZRRE edhe kjo është shpallur jokompetente, andaj edhe ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka konstatuar se DMK në vendimin e saj me të drejt i është referuar dispozitës së nenit 18 të Ligjit për Procedurën Administrative Ligji Nr. 02/L-28 për shkak të dërgimit të kërkesës te një organ që nuk ka kompetencë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit N. M.,
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.